



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 2, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ për Procedurën e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë Nr. 17/2009:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

PLOTËSUES PËR KËTO VENDE TË LIRA TË PUNËS:

Nr.	Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Kodi i pozitës	Vend i lirë/ Zëvendësim
1	IP	Buzëqeshja	Prishtinë	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	01	Zëvendësim
2	IP	Fatosat	Prishtinë	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	02	Zëvendësim
3	IP	Xixëllonjat	Prishtinë	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	03	Zëvendësim
				Një motër edukatore për moshën 0-3 vjeç	04	Zëvendësim
4	IP	Lulevera	Prishtinë	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	05	Vend i lirë
				Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	06	Vend i lirë
				Një motër edukatore për moshën 0-3 vjeç	07	Zëvendësim
5	SHFMU	Pjetër Bogdani	Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	08	Zëvendësim
6	SHFMU	Pavarësia	Prishtinë	Një arsimtar/e për gjuhë angleze	09	Zëvendësim
7	SHFMU	Xhavit Ahmeti	Prishtinë	Një edukator/e për mësim parafillor	10	Zëvendësim
8	SHFMU	Hilmi Rakovica	Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	11	Zëvendësim

9	SHFMU	Isa Boletini	Busi, Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	12	Vend i lirë
10	SHFMU	Ditura	Shkabaj, Prishtinë	Një edukator/e për mësim parafillor	13	Zëvendësim
11	SHFMU	Ditët e Minatorit	Kishëz, Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	14	Vend i lirë
12	SHFMU	Avni Rrustemi	Mramor, Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	15	Zëvendësim
13	SHFMU	Dardania	Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	16	Vend i lirë
14	SHFMU	Meto Bajraktari	Prishtinë	Një arsimtar/e për gjuhë shqipe	17	Vend i lirë
15	SHFMU	Emin Duraku	Prishtinë	Një arsimtar/e për biologji	18	Vend i lirë
16	SHFMU	Ganimete Tërbeshi	Lllukar, Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	19	Zëvendësim
17	SHFMU	Faik Konica	Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	20	Vend i lirë
18	SHFMU	Asim Vokshi	Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	21	Zëvendësim
19	SHFMU	Xhemail Mustafa	Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	22	Zëvendësim
20	SHFMU	Gjergj Fishta	Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	23	Zëvendësim
21	SHFMU	Andon Z. Çajupi	Bardhosh, Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	24	Zëvendësim
				Një edukator/e për mësim parafillor	25	Zëvendësim
22	SHFMU	Naim Frashëri	Prishtinë	Një mësues/e për mësim klasor	26	Vend i lirë
				Një arsimtar/e për art figurativ	27	Zëvendësim
23	SHFMU	Ismail Qemali	Prishtinë	Një arsimtar/e për gjuhë angleze	28	Zëvendësim
				Një arsimtar/e për muzikë	29	Vend i lirë
24	SHFMU	Hasan Prishtina	Prishtinë	Një arsimtar/e për matematikë	30	Vend i lirë
				Një mësues/e për mësim klasor	31	Vend i lirë
				Një mësues/e për mësim klasor	32	Zëvendësim
25	SHML	28 Nëntori	Prishtinë	Një profesor/e për gjuhë shqipe	33	Vend i lirë
26	SHML	Dr. Ali Sokoli	Prishtinë	Një profesor/e për gjuhë angleze	34	Zëvendësim
27	SHML	Prenk Jakova	Prishtinë	Një profesor/e për piano	35	Zëvendësim
				Një profesor/e për këndim koral (10 orë)	36	Vend i lirë
28	SHML	Sami Frashëri	Prishtinë	Një profesor/e për kimi	37	Vend i lirë
				Një profesor/e për matematikë (në gj. turke)	38	Vend i lirë

Aplikacioni i kompletuar duhet të ketë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë)
- Diplomat e kualifikimit (ose çertifikatat)
- Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim (kontratat e punës)

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga DKA në përputhje me Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse (UA Nr. 17/2009 dhe UA Nr. 20/2013). Kandidatët e pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim.

Sqarime shtesë:

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Me rastin e marrjes së aplikacionit, kandidatët mund të marrin edhe dokumentin ku përshkruhet procedura e përzgjedhjes dhe dokumentin ku përshkruhen kriteret e paraseleksionimit.

Për intervistë do të ftohet tre kandidatët që i plotësojnë më së miri kushtet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Përzgjedhja për intervistë do të bëhet bazuar në kualifikimet formale adekuate, përvojën e punës relevante në arsim, trajnimet e përfunduara relevante të akredituara nga MASHT dhe notën mesatare gjatë studimeve.

Nëse i njëjti person aplikon në më shumë se një pozitë/institucion, atëherë për secilën pozitë/institucion duhet të dorëzojë aplikacionin e veçantë të kompletuar. Por, nëse kandidati i plotëson kushtet për t'u ftuar në intervistë, mund të ftohet në intervistë vetëm në një institucion, përkatësisht vetëm për një pozitë.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.